

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

**12.04.2023
Ora 12:04**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2023”.

PJESËMARRJA :

● **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,

Znj. P.Doçaj, Znj. V. Ballgjini

● **Parti Politike:**

PDIU, PL, PD, PDSH, PLL

● **Të tjerë**

KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Atëherë në seancën e sotme kemi në rend dite këto çështje: Kemi projektvendimin “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2023”.

Projektvendimin “Për caktimin e kohës së transmetimit në radiotelevizionin publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Projektvendimin “Për delegimin e kompetencës për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Projektvendim për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në Bashkinë Tiranë. Më pas kemi një vlerësim të raportimeve mbi veprimtarinë e institucioneve, mbi periudhën 24 mars – 30 mars 2023 dhe për periudhën 31 mars – 6 prill 2023. Kemi shqyrtimin e kërkesë së shoqatës “Sebastia” dhe Shoqatës për Kulturë Demokratike, për akreditim vëzhguesish. Një kërkesë e tillë “Qendrës për Trajnim Zgjedhor të Vazhdueshëm” dhe “Paneli Zgjedhor për

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Ankesa dhe Parashtresa”. Kemi pastaj shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues, zotin Gentjan Fiqiri Muça, kandidat për deputet i listës shumemërore të Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, Qarku Tiranë” në zgjedhjet e prillit të vitit 2021. Kemi po ashtu shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zonjën Elsa Bashkim Voka, kandidat për deputet i listës shumemërore të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët, për Qarkun Berat, kandidat për zgjedhjet e prillit 2021. Kemi shpalljen e moszgjedhshmërisë për kandidatët në radhën në listën shumemërore të Partisë Socialiste dhe të Koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim. Kemi verifikimin e të dhënave të deklaruara për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte kandidat për kryetar bashkie dhe anëtar të këshillit bashkiak për zgjedhjet e 14 majit. Gjatë shqyrtimit do i përmendim edhe emrat e kandidatëve respektiv. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, projektvendimin “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2023”. Zoti sekretar.

Z. Y. Merkaj: Po faleminderit! Neni 15 shkronja e e Ligjit Për Partitë Politike përcakton masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore dhe neni 92 i këtij ligji parashikon rregullat e shpërndarjes së fondit për ndihmë financiare për kryerjen e llogarisë vjetore të partive politike si më poshtë:

- 70 % sipas numrit të deputetëve të fituara në zgjedhjet e fundit parlamentare,
- 20% e fondit në mënyrë të barabartë ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë fituar mbi 10.000 vota në zgjedhjet e fundit parlamentare,

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

- 10 % sipas përqindjes së fituar ndërmjet partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1% të votave në shkallë vendi. Pjesa e mbetur nga 10-përqindëshi i shtohet fondit prej 70 % që u ndahet partive parlamentare. Ligji për buxhetin e vitit 2023 ka parashikuar fondin prej 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekë si mbështetje financiare për partitë politike për vitin 2023. Në zbatim të dispozitave të sipërcituara kemi të hartuar edhe projektvendimin e mësipërm. Qëllimi i këtij projektvendimi është të përcaktojë mënyrën e përllogaritjes dhe kriteret për shpërndarjen e fondit vjetor si ndihmë financiare partive politike si dhe përcaktimin e partive politike që u lind e drejta të fitojnë këtë fond vjetor. Në zbatim të vendimit nr. 21, të vitit 2021 të Komisionit Rregullator është shpallur rezultati përfundimtar i zgjedhjeve për Kuvend, i datës 25 prill 2021 dhe shuma e dhënë në buxhetin e shtetit do u shpërndahet partive politike si më poshtë:

- Përllogarisim 70% të vlerës prej 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekë, e cila është e barabartë me 241.920.000 (dyqind e dyzet e një milion e nëntëqind e njëzet mijë) lekë. Kjo shumë pjesëtohet me numrin e deputetëve të parlamentit shqiptar, 140 deputetë. Rezultati prej 1.728.000 (një milion e shtatëqind e njëzet e tetë mijë) lekë shumëzohet me numrin e deputetëve të secilës parti politike që ka fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare (25 prill 2021). Sipas rezultatit përfundimtar Partia Socialiste e Shqipërisë ka fituar 74 mandate, Partia Demokratike ka fituar 50 mandate, Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet 2 mandate, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut 1 mandat, Partia Republikane 3 mandate, Partia Agrare Ambjetaliste e Shqipërisë 1 mandat, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar 1 mandat, Partia Lëvizja e Legalitetit 1 mandat, Partia e Lirisë 4 mandate, Partia Social Demokrate 3 mandate.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

- 20% e shumës totale ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare. Përlllogarisim 20% të vlerës 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekë dhe nga kjo vlerë del 69.120.000 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e njëqind e njëzet mijë) lekë, e cila pjesëtohet me 11 (numri i partive parlamentare dhe partive politike që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare). Vlera që përfitohet është 6.283.636 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

- Përlllogarisim 10% të vlerës 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekë të miratuar nga Buxheti i Shtetit. Kjo vlerë është 34.560.000 (tridhjetë e katër milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, e cila shumëzohet me përqindjen përkatëse të partive politike të cilat kanë fituar mbi 1% të votave në zgjedhjet e fundit për Kuvend. Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga fondi 10% i shtohet partive që kanë fituar 70% të fondit të përgjithshëm. Shuma totale që përfiton secila parti politike si mbështetje financiare për vitin 2023, është shumatorja e të gjitha shumave që rezultojnë nga llogaritja e mësipërme që sapo shpjeguam. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësues të partive politike, në lidhje me këtë projektvendim? Po përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jemi njohur kohë më përpara. Jemi dakord me vendimmarrjen, megjithëse shumë e vonuar zoti Komisioner.

Z. I. Celibashi: Po.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Përfaqësuesi i Partisë së Legalitetit: Përfaqësuesi i Partisë së Legalitetit dëgjova aty në projektvendim që Partia e Legalitetit përfaqësohet nga një deputet. Mesa di unë të paktën kemi dy. Është dhe...

Z. I. Celibashi: Në llogaritjen e buxhetit që marrin partitë parë kjo me numrin e mandateve, ne e konsiderojmë numrin e mandateve që kanë marrë partitë politike sipas vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Gjatë legjislaturës ky numër mund të ndryshojë, por Komisioneri Qendror i Zgjedhjeve merr në referim momentin e parë, fotografinë e parë të konfigurimit të Kuvendit të Shqipërisë. Sikurse thashë gjatë legjislaturës partitë politike pjesëmarrëse të koalicionit në një moment e merr mandatin një kandidat për deputet, e lë ai, e merr tjetri, ai tjetri mund të jetë i një partie tjetër ndaj dhe për këtë arsye në interpretim sipash nesh korrekt të ligjit duhet ti qendrojmë rezultatit të zgjedhjeve, të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe numrit të mandateve që ka marrë secila parti, i vërtetuar ky numër me vendimmarjen e KQZ-së kur ka shpallur vendimin përfundimtar të zgjedhjeve.

Përfaqësuesi i Partisë së Legalitetit: Meqenëse nuk jemi njohur me projektvendimin. Nuk e di se ç'shëmë i takon Partisë së Legalitetit, por me projektvendimin e mëparshëm ka qenë 9,7 milion.

Z. I. Celibashi: Nuk e di, do e shpallim këtë, por ajo çfarë prezantoi Sekretari ishin kriteret mbi të cilat llogaritet shuma që përfiton çdo parti politike. Përfaqësues të partive të tjera politike?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Përfaqësuesi i PL-së: I nderuar Komisioner nuk kemi ndonjë gjë në përlllogaritjen e shumatores së fundit që është tabela por thjesht tek pjesa për Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim të zëvendësohet me Partia e Lirisë sepse dihen ndryshimet që janë bërë së fundmi. Mos ishte ky projektvendim (*nuk dëgjohet*) me partinë Socialiste për Integrim. Mendoj se është e drejtë

Z. I. Celibashi: Po, kjo është e vërtetë sepse ky projektvendim sikurse e tha dhe kolegu juaj ka kohë që i është shpërndarë partive politike për njohje dhe në saktësim të asaj çfarë tha kolegu, përfaqësues i Partisë Demokratike, ky vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mund të konsiderohet i vonë, nëse mund ta konsiderojmë vonë, 12 ditë që kanë kaluar nga afati ligjor brenda të cilit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të duhet ta merrte këtë vendim sepse sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, KQZ nuk mund ta marrë këtë vendim përpara datës 31 mars sepse do të duhet të presi datën 31 mars, datë e cila është afati i fundit për depozitimin e raporteve nga partitë politike. Dhe ato parti politike të cilat nuk e kanë depozituar raportin brenda datës 31 Mars nuk përfitojnë financim, kështu që afati për KQZ-në ka filluar nga data 1 prill, duke mos e llogaritur datën 1 Prill si ditë gënjeshtresh, kështu që fillon nga data 2. Dakord, mirë atëherë, sipas vlerësimit të bërë nga ana jonë, fondi që do të shpërndahet për partitë politike si ndihmë financiare vjetore për vitin 2023 në total është edhe njëherë 345.341.079 (treqind e dyzet e pesë million e treqind e dyzet e një mijë e shtatëdhjetë e nëntë) lekë, i cili ju shpërndahet partive politike si vijon. Partia Socialiste 151.494.783 (njëqind e pesëdhjetë e një million e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre) lekë, Partia Demokratike 106.402.261 (njëqind e gjashtë million e katërqind e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) lekë, Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet 9.753.658 (nëntë million e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë,

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut 8.018.647 (tetë milion e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë) lekë, Partia Republikane 11.488.679 (njëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, Partia Agrare Ambjentaliste 8.018.647 (tetë milion e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë) lekë, Partia Lëvizja për zhvillim kombëtar, dhe për këtë parti do të reflektojmë për ndryshimin e emrit, 8.018.647 (tetë milion e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë) lekë, Partia Lëvizja e Legalitetit 8.018.647 (tetë milion e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë) lekë, Partia e Lirisë 15.577.215 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekë, Partia Social Demokrate 12.266.269 (dymbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, Partia Nisma Thurje 6.283.636 (Gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë. Pra këto ishin partitë politike të cilat përfitojnë ndihmë financiare nga buxheti i shtetit për veprimtarinë e tyre politike, për vitin 2023. Në ditët në vijim besoj do të marrim edhe vendimin për shpërndarjen e fondit për fushatën elektorale, pasi Kuvendi të miratojë buxhetin përkatës.

Vendimi nr. 309

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

12.04.2023
Ora 12:18

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e kohës së transmetimit në radiotelevizionin publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. P.Doçaj, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PDIU, PL, PD, PDSH, PLL**
- **Të tjerë** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Neni 19, pika 1 e Kodit Zgjedhor parashikon Kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për monitorimin nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara të fushatës zgjedhore.

Z. I. Celibashi: Ndjesë, përpara se të vazhdojmë me këtë. Do e shtyjmë për nesër meqenëse ua kemi dërguar partive politike vetëm një orë më përpara nëse nuk gabo, apo jo?

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. I. Celibashi: Nuk ka nevojë që ta bëjnë ata kërkesën.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

12.04.2023
Ora 12:19

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për delegimin e kompetencës për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,

Znj. P.Doçaj, Znj. V. Ballgjini

• **Parti Politike:**

PDIU, PL, PD, PDSH, PLL

• **Të tjerë**

KRIIK

Z. I. Celibashi: Atëherë kalojmë tek pika e tretë e rendit të ditës, që ka të bëjë me delegimin e kompetencës për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, për këtë zgjedhje.

Z. Y. Merkaj: Me vendimin nr. 23 datë 01.02.2023 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka evidentuar procedurat për akreditimin dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në komisionet zonale të administrimit zgjedhor, komisionet e QV-ve dhe VNV-ve. Në pikën 8 të këtij vendimi është parashikuar dhe delegimi i kompetencës për akreditimin e vëzhguesve nga KQZ-ja në KZAZ. Referuar kësaj pike dhe këtij neni është përgatitur dhe projektvendimi për delegimin e kompetencës së KSHZ-së në KZAZ për akreditimin e vëzhguesve dhe subjekteve zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike në lidhje me këtë projektvendim? Nuk kemi. Mirë thjeshtë për të shpjeguar më mirë edhe publikun nëpërmjet medias, qëllimi i këtij akti është për të lehtësuar procesin e akreditimit të vëzhguesve zgjedhor për zgjedhjet e 14 majit, duke e decentralizuar përgjegjësinë e akreditimit në nivelin e KZAZ-ve. Gjithsesi pa i hequr të drejtën dhe përgjegjësinë Komisionerit për të vëndosur rast pas rasti nëse nuk funksionon poshtë procesi i vendimmarrjes nga KZAZ-ja.

Vendimi nr. 310

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

12.04.2023
Ora 12:20

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 1796, QV nr. 1796/01, QV nr. 1796/02, Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaaj, Znj. M. Koja,

Znj. P.Doçaj, Znj. V. Ballgjini

• **Parti Politike:**

PDIU, PL, PD, PDSH, PLL

• **Të tjerë**

KRIIK

Z. I. Celibashi: Atëherë vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaaj: Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja, sipas përcaktimit të nenit 62, pika 4, të Kodit Zgjedhor. Në KQZ është administruar propozimi i Administratorit, të autorizuar nga kryetari i bashkisë Tiranë, të njësisë administrative nr.4, për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjeve të 3 qendrave të votimit, konkretisht të QV nr.1796, QV nr.1796/01 dhe QV nr.1796/02, nga ambjent privat i zotit Robert Bano në ambjent privat të zotit Kastriot Isufaj, me arsyetimin se objekti i zotit Robert Bano nuk plotëson kushtet dhe kriteret ligjore për të shërbyer si qendër votimi. Ambienti i zotit Kastriot isufaj ka shërbyer si qendër votimi edhe në zgjedhjet e kaluara. Nga verifikimi i kryer nga administrata e KQZ, rezulton se ambjenti i zotit Roberto Bano

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

nuk ka kushte për të shërbyer si qendër votimi pasi ka mungesë instalimesh të energjisë elektrike dhe thujse është në fazë karabinare. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit ndryshimin e vendndodhjes së këtyre tre qendrave të votimit. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive politike? Po

Z. F. Nuri, përfaqësuesi i koalicionit “Bashkë Fitojmë”: Të nderuar, në lidhje me pikën 4 të rendit të ditës, ne jemi vënë në dijeni nga projektvendimin për elementët teknikë dhe konstatojmë se është pikërisht administrator i njësisë nr. 4, i cili e ka propozuar më përpara këtë qendër votimi, po themi këtë ambient. Nuk e kuptojmë përse këto ambiente janë propozuar kur fare mirë nuk i kishin kushtet e përshtatshme përpara një muaji, përpara 30 ditësh, sepse po ta vëmë re bëhet fjalë për ambiente që janë në gjëndje karabinam pa bërë instalimet elektrike, nuk kanë qenë gati. Tani a është bërë qëllimisht kjo gjë, që është propozuar një ambient kur dihej që nuk do të miratohej dhe tani në minutë të fundit kërkohet zëvendësimi i këtij? Ne si subjekt zgjedhor kërkojmë që situata të verifikohet në terren nga inspektorët e KQZ-së, gjithashtu kërkojmë që të merren masa ndaj administratorit sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Theksojmë gjithashtu i nderuar Komisioner se jemi vënë në dijeni kohët e fundit, ditët e fundit në lidhje me problematikën e zhvendosjes së zgjedhësve. Janë 1.2 ose 1.3 milion qytetarë, votues që rezultojnë, që kanë ndryshime në QV-të e tyre të votimit dhe tani shpresojmë që këto teknalitetet e fundit mos të bëhen bazë për ndryshime të minutës së fundit të QV-ve sepse do të çorjentojnë komplet votuesit ditën e zgjedhjeve.


*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Dakord me çfarë ju sollët në vëmendje. Le të verifikojmë më shumë për arsyet e vendosjes së QV-së në atë ambjent nëse dihej që nuk i kishte ato kushte dhe ndërkohë të bëhet një verifikim dhe nëqoftëse për këtë projektvendim ndoshta partitë politike nuk kanë patur kohën e mjaftueshme në dispozicion për të bërë dhe ato verifikimet e pavarura nga ne. Mendoj që ta shtyjmë për një ditë tjetër dhe besoj se për 24 orë ose dy ditë të themi më mirë partitë politike do të kenë mundësi që të verifikojnë situatën e këtyre QV-ve.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

12.04.2023
Ora 12:21

RENDI I DITËS

Projektvendim “Vlerësim i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 24 mars – 30 mars 2023.

PJESËMARRJA :

● **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,

Znj. P.Doçaj, Znj. V. Ballgjini

● **Parti Politike:**

PDIU, PL, PD, PDSH, PLL


● **Të tjerë**

KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika 5 që lidhet me vlerësimin e raportimeve për veprimtaritë e institucioneve publike të disa institucioneve publike, për periudhën 24 mars – 30 mars 2023.

Znj. M. Koja: Sipas rendit të ditës sot kemi shpalljen e vendimit për periudhën 24 mars – 30 mars 2023. Gjatë kësaj periudhe, në ndërfaqe janë raportuar 353 aktivitete nga 67 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se nga këto 16 aktivitete janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Arsyet e mosraportimit në afat kanë qenë për shkaqe të lapsuseve në hedhjen e datës dhe nga sa është verifikuar një pjesë e institucioneve kanë qenë në cilësinë e të ftuarit, pra nuk kanë patur synim për të raportuar. Për disa veprimtari nuk krijohet bindja për karakterin publik që kanë, janë veprimtari me karakter administrativ, janë mbledhje, analiza, kështu që për këto nuk mendojmë se jemi përpara shkeljeve. Në këto kushte propozojmë moskonstatimin e shkeljes dhe pushimin e procedimit administrativ ndaj këtyre institucioneve:

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Ministria e Financës dhe e Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes, Ministri i shtetit për marrëdhëniet me Parlamentin, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Prefekti i Qarkut Shkodër, bashkitë Tiranë, Korçë, Kurbin, Tepelenë dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Pogradec. Ky është vendimi që propozojmë për sot.

Z. I. Celibashi: Dakord! Atëherë, cilat janë këto institucione, përjashto ato të cilat janë ftuar në aktivitetet e të tretëve, të tjerë, institucionet që thonë që nuk kemi bërë raportimin në kohë, për shkak të lapsusit?

Znj. M. Koja: Të themi kanë raportuar në mars për shkurtin, pra nëse do të kishin raportuar i treti dhe jo i dyti, do të ishte brenda afatit, ky është lapsusi, në përcaktimin e muajit.

Z. I. Celibashi: Dakord! Përfaqësues të partive politike në lidhje me këtë çështje? Nuk kemi.

Vendimi nr. 311

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

12.04.2023
Ora 12:27

RENDI I DITËS

Projektvendim “Vlerësim i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 31 mars – 6 prill 2023”.

PJESËMARRJA :

● **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,

Znj. P.Doçaj, Znj. V. Ballgjini

● **Parti Politike:**

PDIU, PL, PD, PDSH, PLL

● **Të tjerë**

KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës.

Znj. M. Koja: Sot vijojmë me periudhën e monitorimit 31 mars deri më 6 prill 2023. Janë raportuar gjithsej 262 veprimtari nga 60 institucione raportuese. Nga verifikimi paraprak rezulton se 11 veprimtari janë në tejkalim të afatit ligjor. Këto veprimtari janë të 8 institucioneve. Ndërkohë gjatë kësaj periudhe monitorimi është bërë ndalimi i një veprimtarie për tu zhvilluar nga Bashkia Korçë. Ndërkohë jemi në përfundim dhe do të dalim me vendimmarrje në seancën e rradhës. Vijojmë të bëjmë atë thirrjen tonë që monitorimet bëhen mbi baza ditore dhe respektimi i afatit është shumë i rëndësishëm. Ndërkohë i ftojme të gjithë të respektojnë dhe udhëzimet apo të sillen në vëmendje të Komisionerit mbi detyrimin për raportim të veprimtarive me karakter publik duke mos i ngatërruar ato me veprimtari të natyrave të tjera që nuk janë institucionale. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Tani në lidhje me këtë periudhë 31 mars – 6 prill, u kemi kërkuar sqarime institucioneve?

Znj. M. Koja: Po u kemi kërkuar 4 institucioneve, sepse për 4 të tjerët janë raste të ftuarish, kanë qenë të ftuar dhe nuk ka qenë e nevojshme të vijonim hetimin.

Z. I. Celibashi: Tjetër, për këtë periudhë kemi denoncime ose konstatime nga Organizata të Shoqërisë Civile?

Znj. M. Koja: Kemi dhe janë duke u shqyrtuar.

Z. I. Celibashi: Në lidhje me këtë periudhë. Atyre u është bërë me dije për rendin e ditës për shqyrtimin e...

Znj. M. Koja: po u është komunikuar.

Z. I. Celibashi: Më bëni dhe një komunikim tjetër me këto organizata për raste të cilat ata i kanë sjellë në vëmendjen tonë duke i bërë me dije dhe nëse është rasti i sqarimit që mund të kenë bërë institucione të ndryshme për aktivitetet të cilat nga këto organizata janë konsideruar si në shkelje të ligjit. Dakord!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

12.04.2023
Ora 12:29

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së shoqatës “Sebastia” dhe Shoqatës për Kulturë Demokratike, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

● **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaç, Znj. M. Koja,

Znj. P.Doçaj, Znj. V. Ballgjini

● **Parti Politike:**

PDIU, PL, PD, PDSH, PLL

● **Të tjerë**

KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë shqyrtimi i kërkesës së shoqatës “Sebastia” dhe Shoqatës për Kulturë Demokratike, për akreditim vëzhguesish për zgjedhjet 14 majit 2023.

Z. Y Merkaç: Shoqata “Sebastia” ka paraqitur në KQZ kërkesën për akreditimin e 3 vëzhguesve afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu Shoqata për Kulturë Demokratike ka paraqitur në KQZ kërkesën dhe dokumentacionin për akreditimin e 34 vëzhguesve afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor dhe dokumentacioni është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte kërkojmë akreditimin e këtyre vëzhguesve sipas kërkesës së shoqatave. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë e miratojmë kërkesën për akreditimin e vëzhguesve për këto 2 shoqata, shoqata “Sebastia” dhe Shoqata për Kulturë Demokratike.

Vendimi nr. 312

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

12.04.2023
Ora 12:30

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së “Qendrës për Trajnim Zgjedhor të Vazhdueshëm” dhe “Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,

Znj. P.Doçaj, Znj. V. Ballgjini

• **Parti Politike:**

PDIU, PL, PD, PDSH, PLL

• **Të tjerë**

KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek shqyrtimi i kërkesës së Qendrës për Trajnim Zgjedhor të Vazhdueshëm” dhe “Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa”.

Z. Y Merkaj: Qendra për Trajnim Zgjedhor të Vazhdueshëm ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 2 vëzhguesve afatshkurtër dhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresat ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 8 vëzhguesve afatgjatë. Kërkesa dhe dokumentacioni është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe si e tillë duhet pranuar. Në këto kushte i kërkojmë Komisionerit të pranojë kërkesën e shoqatave. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Dakord! Miratohet akreditimi i këtyre vëzhguesve për këto dy subjekte.

Vendimi nr. 313

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

12.04.2023
Ora 12:31

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Gentjan Fiqiri Muça, kandidat për deputet i listës shumemërore të Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, Qarku Tiranë”.

PJESËMARRJA :

● **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,

Znj. P.Doçaj, Znj. V. Ballgjini

● **Parti Politike:**

PDIU, PL, PD, PDSH, PLL

● **Të tjerë**

KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën 9, Shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Gentjan Fiqiri Muça, kandidat për deputet në listat shumemërore të Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, Qarku Tiranë.

Z. Y. Merkaj: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin dhe zbatimin e ndalimit, sipas ligjit nr. 138 për emërimin në funksionet publike si dhe verifikimin e formularit të vetëdeklarimit. Në zbatim të këtyre dispozitave zoti Gentjan Fiqiri Muça, kandidat për deputet i Koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim, qarku Tiranë, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2036. Përpara miratimit të listës së kandidatëve është bërë verifikimi paraprak dhe është

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

konstatuar se nuk është në kushtet e ndalimit. Në këto kushte Komisioneri ka miratuar listën shumemërore të Koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, është subjekti vetëdeklarues ka deklaruar të dhëna të cilat nuk kanë të bëjnë me masa shtrënguese të marra në shtetet e huaja. Në këto kushte bazuar në nenin 8, pika 1 e ligjit nr. 138, të vitit 2015 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka dërguar shkresën për verifikim të thelluar organit të Prokurorisë së Përgjithshme. Në datën 29.03.2023 Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin, zotin Gentjan Muça. Konstatohet se nuk përfshihet në fushën e ndalimit të veprimit të nenit 2, të ligjit nr. 138, të vitit 2015. Referuar të dhënave të disponuara të kandidatit, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të kandidimit ose moszgjedhshmërisë. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr 409, datë 23.06.2021 ka miratuar shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore për caktimin e kandidatëve fitues si dhe rirënditjen e kandidatëve. Në listën për Qarkun Tiranë, të Koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim, Gentian Muça ende nuk ka marrë mandatin e deputetit. Nuk është në kushtet e ndalimit.

Z. I. Celibashi: Po përfaqësues të partive politike?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Siç jeni dhe në dijeni, sç ka qenë edhe në momentin e parë kur është bërë kandidimi i zotit Gentjan Muça për deputet, në bazë të ligjit ai ka deklaruar të gjitha të dhënat që dispononte, nuk ka qenë kurrë si subjekt ndalimi, por duke qenë se është transparent mbas ligjit dhe detyrimit ligjor, ka bërë të gjithë deklaratimet e mundshme. Ky rezultat dy vjet me vonesë nga ana e Prokurorisë së

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Përgjithshme tregon edhe njëherë eficientë që ka Prokuroria e Përgjithshme për ndalimin e këtyre rasteve dhe për marrjen dhe realizimin e një jetimi, ndaj ne mendojmë se edhe vendosja në këtë mbledhje nuk ishte e nevojshme në këtë mbledhje që janë për zgjedhjet lokale, ndërkohë që është rezultat për zgjedhje të mëparshme. Gjithsesi siç e tha dhe Sekretari i Përgjithshëm nuk ka qenë kurrë në kushtet e ndalimit dhe kjo është rezultati nga ky hetim i thelluar nga ana e prokurorisë.

Z. I. Celibashi: Përfaqësues nga parti të tjera politike? Atëherë, sikurse mundet të kuptoni ky është një detyrim i ligjit për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të disponojë pasi merr rezultatet nga verifikimi i thelluar nga organi i Prokurorisë. Ka qëlluar që ky rezultat të vijë nga zyra e Prokurorit të Përgjithshëm në këtë kohë dhe KQZ ka afat Brenda të cilit duhet ta shqyrtojë rezultatit e verifikimit nga ana e zyrës përkatëse të Prokurorit të Përgjithshëm. Me periudha 2 vjeçare nuk është rasti i parë në fakt që nga organi i prokurorisë është marrë ky raport për të bërë verifikimin pasi sikurse e dinë të gjithë implikon edhe marrjen e informacionit nga shtete të tjera dhe shpeshherë kjo zyrë është e detyruar të presë përgjigjet përkatëse nga organet juridiksionale të huaja.

Vendimi nr. 314

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

12.04.2023
Ora 12:36

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Elsa Bashkim Voka, kandidat për deputet i listës shumemërore të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët, Qarku Berat”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,

Znj. P.Doçaj, Znj. V. Ballgjini

• **Parti Politike:**

PDIU, PL, PD, PDSH, PLL

• **Të tjerë**

KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, pika 10.

Z. Y Merkaj: Zonja Elsa Voka, kandidatja e propozuar për deputet nga Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët, Qarku Berat” ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit. Përpara miratimit të listës së kandidatëve për deputet të këtij subjekti zgjedhor është bërë verifikimi paraprak i formularit të vetëdeklarimit dhe është përcaktuar se nuk është në kushtet e ndalimit. Me vendimin nr. 167, dt. 18.03.2021 ka miratuar listat shumemërore të Koalicionit ABEOK. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit konstatohet se subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka marrë masa shtrënguese në shtete të huaja. Bazuar në nenin 8, pika 1 të ligjit nr. 138, të vitit 2015 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka kaluar rastin për verifikim të thelluar

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

organit të Prokurorisë së Përgjithshme. Në datën 29.03.2023 Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin, zonjën Elsa Bashkim Voka. Zonja Elsa Voka si kandidate e listës shumëmemërore e Koalicionit ABEOK në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021 Qarku Berat, nuk ka marrë mandatin e deputetit. Subjekti zgjedhor Koalicioni ABEOK referuar neneve 162 dhe 163 të Kodit Zgjedhor nuk ka fituar asnjë mandat në Qarkun e Beratit dhe në këto kushte, në rastin e një vetshqyrtimi në analizë të nënit 10 dhe 11 të ligjit nr. 138, të vitit 2015 dhe nenit (*nuk dëgjohet*) të Kodit të Procedurës Administrative vlerësohet se ka humbur objektin e qëllimit të procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve. Në këto kushte i kërkojmë Komisionerit deklarin e procedurës administrative të papërfunduar dhe pa vendim përfundimtar.

Z. I. Celibashi: Dakord! Atëherë, meqenëse subjekti vetëdeklarues në asnjë rrethanë nuk mund të përfitojë mandat jam dakord me propozimin për të përfunduar pa vendimmarrje shqyrtimin e rezultatit të verifikimit për këtë subjekt.

Vendimi nr. 315

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

12.04.2023
Ora 12:39

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shpalljen e moszgjedhshmërisë së kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Shkodër, z. Ilir Hamit Beqaj, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,

Znj. P.Doçaj, Znj. V. Ballgjini

• **Parti Politike:**

PDIU, PL, PD, PDSH, PLL

• **Të tjerë**

KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër që ka të bëjë me shpalljen e moszgjedhshmërisë së kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Shkodër.

Z. Y Merkaj: Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvend për shkak të dorëheqjes së deputetit (*nuk dëgjohet*) në zonën zgjedhore Qarku Shkodër të propozuar nga Partia Socialiste. Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor përcaktohet se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit deputetit të rradhës të listës shumemërore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 410, dt. 23.06.2021 ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë ku ka miratuar dhe listën shumemërore të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

deputetëve të zgjedhur për secilin subjekt në zonën zgjedhore. Partia Socialiste në zonën zgjedhore Qarku Shkodër ka fituar 3 mandate. Kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit është kandidati me numër rendor 4, zoti Ilir Beqaj, i cili sipas ligjit nr. 138, të vitit 2015 është njoftuar për të depozituar formularin e vetëdeklarimit. Afati i fundit për dorëzimin e këtij formulari ka qenë data 07.04.2023. Brenda këtij afati nuk është dorëzuar dhe nuk është depozituar formulari i vetëdeklarimit. Në këto kushte referuar nenit 5, pika 2, të ligjit nr. 138, të vitit 2015 mosdorëzimi i formularit u bë shkak i moszgjedhjes së kandidatit si deputet për Kuvendin e Shqipërisë. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet për Kuvendin e Shqipërisë të kandidaturës së rradhës të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste, zotit Ilir Beqaj, si kandidat për Qarkun e Shkodrës. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësues të partive politike nuk besoj se ka. Atëherë meqenëse kandidati i rradhës zoti Ilir Hamit Beqaj nuk ka depozituar formularin e vetëdeklarimit, nuk ka pranuar rrjedhimisht të marrë mandatin, konstatoj moszgjedhshmërinë e tij si kandidat i rradhës në listën shumëmemërore dhe ti kërkojmë kandidatit të rradhës për të dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit.

Vendimi nr. 316

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

12.04.2023
Ora 12:41

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shpalljen e moszgjedhshmërisë së kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, Qarku Shkodër, z. Bardh Ali Spahia, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

● **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaaj, Znj. M. Koja,

Znj. P.Doçaj, Znj. V. Ballgjini

● **Parti Politike:**

PDIU, PL, PD, PDSH, PLL

● **Të tjerë**

KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër.

Z. Y Merkaaj: Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvend. Vakancë e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit i zotit Zef Hila, i zgjedhur në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, të propozuar nga Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim. Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 25 prill 2021. Me vendimin nr. 410, të Komisionit Qendror i Zgjedhjeve dt. 23.06.2021 është shpallur rezultati përfundimtar i zgjedhjeve për kuvendin e Shqipërisë ku ky koalicion në qarkun e Shkodrës ka fituar 5 mandate. Kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit nga lista shumëmemërore të këtij koalicioni është kandidati me numër rendor 5 zoti Bardh Ali Spahia, i cili sipas vendimit nr. 17

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

të Kuvendit të Shqipërisë është njoftuar për depozitimin në Komisioni Qendror të Zgjedhjeve të formularit të vetëdeklarimit. Afati përfundimtar për dorëzimin e këtij formulari ka qenë data 07.04.2023. Brenda këtij afati nuk është dorëzuar dhe nuk është depozituar formulari i vetëdeklarimit. Në këto kushte referuar nenit 5, pika 2, të ligjit nr. 138, të vitit 2015 refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit bëhet shkak për moszgjedhshmërinë e kandidatit në funksionin e deputetit. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet për Kuvendin e Shqipërisë të zotit Bardh Spahia. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po ashtu sikurse dhe rasti i zotit Beqaj dhe rasti i zotit Bardh Spahia në kushtet kur nuk ka depozituar formularin e vetëdeklarimit dhe nuk ka pranuar që të marrë mandatin e deputetit, duke konstatuar moszgjedhshmërinë e këtij kandidati të rradhës për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, do i kërkojmë kandidatit pasardhës për të plotësuar kërkesën e ligjit, për depozitimin e formularit të vetëdeklarimit.

Vendimi nr. 317

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

**12.04.2023
Ora 12:43**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të subjekteve vetëdeklaruese për disa bashki.

PJESËMARRJA :

● **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaçaj, Znj. M. Koja,

Znj. P.Doçaj, Znj. V. Ballgjini

● **Parti Politike:**

PDIU, PL, PD, PDSH, PLL

● **Të tjerë**

KRIIK

Z. I. Celibashi: Në vijim kemi projektvendimet që lidhen me verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për kandidatët vijues: Kreshnik Riza Hajdari, kandidat për kryetar bashkie, i propozuar nga Partia Socialiste për Bashkinë e Korçës; kandidati Qerim Ismail Ismailaj, i propozuar nga Partia Socialiste për Bashkinë Mallakastër; kandidatin Artur Xheke Bushi, kandidat për kryetar bashkie, i propozuar nga Partia Socialiste për Bashkinë Krujë; kandidati Kristian Luigj Shkreli, i propozuar nga Partia Socialiste si kandidat për kryetar të Bashkisë së Vaut të Dejës; kandidati për kryetar bashkie në Has, zoti Beqir Zek Mulaj, i propozuar nga Partia Socialiste; kandidati për kryetar bashkie në Shijak, zoti Rezart Xhelal Tusha, i propozuar nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”; kandidati për kryetar bashkie për Bashkinë e Devollit, zoti Elvis Jani Hajdërlli, i propozuar nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”; kandidati për kryetar për Bashkinë Himarë, i propozuar nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”, zoti Dhionisios (Alfred) Petro Beleri; kandidati për kryetar të Bashkisë Mallakastër, zoti Agron Faslli Kapllanaj, i

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

propozuar nga Partia Demokratike; kandidati për kryetar të Bashkisë Kukës, zoti Abedin Rasim Oruçi, i propozuar nga Partia për Europeanizimin dhe Integrimin e Shqipërisë; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Bulqizë, zoti Arjan Liman Xheta, propozuar nga Partia Demokratike; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Mirditë, zoti Ertor Ndue Ndreu, propozuar nga Partia Demokratike; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Shijak, zoti Euland Haki Daja, propozuar nga Partia Demokratike; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Tropojë, zoti Fatlind Bujar Sokolaj, propozuar nga Partia Demokratike; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Bulqizë, zoti Ylli Rushit Xhafa, i propozuar nga Partia Demokratike; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Berat, zoti Syrja Yzedin Çobo, i propozuar nga Partia Demokratike; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Tropojë, zoti Adriatik Kadri Sallahu, i propozuar nga Partia Aleanca Arbnore Kombëtare; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Pukë, zoti Pashk Gjergj Gjetaj, propozuar nga Partia Lëvizja e Legalitetit; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Gramsh, zoti Sokol Abedin Kullolli, propozuar nga Partia e Reformave Demokratike Shqiptare; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Tiranë, zoti Afrim Ali Kica, propozuar nga Partia Lëvizja e Legalitetit; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Tiranë, zoti Kreshnik Faslli Myrtollari, propozuar nga Partia Agrare Ambjentaliste; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Shkodër, zoti Arbis Arif Vjerdha, propozuar nga Partia Agrare Ambjentaliste; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Shijak, zoti Armelin Qazim Koni, propozuar nga subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Vorë, zoti Arsen Belaj, propozuar nga Partia “Aleanca Progresiste LZHK”; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Bulqizë, zoti Ali Hekuran Gjeta, propozuar nga Partia

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

“Aleanca Progresiste LZHK”; kandidati për anëtar këshilli në Bashkinë Kuçovë, zoti Marceljo Sami Marra, propozuar nga Partia “Aleanca Progresiste LZHK”; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Vlorë, zoti Erald Hysen Guna, propozuar nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Dibër, zoti Sokol Mehdi Sava, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Vlorë, zoti Valter Murat Hasanaj, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë; kandidati për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Fushë – Arrëz, zoti Emil Xhafer Musliaj, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Këto janë. Zoti Sekretar, përmbledhtazi mbi shkaqet.

Z. Y. Merkaç: Të gjithë kandidatët janë subjekte vetëdeklaruese, pasi kanë dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e deklarimit. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të gjithë kanë deklaruar që kanë pasur masa shtrënguese në shtetet e huaja. Në këto kushte, duke iu referuar edhe ligjit nr. 138 të vitit 2015, kemi menduar që të gjithë këta t’ia kalojmë për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme si organi kompetent për hetime të mëtejshme. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit të marrë vendim e t’i dërgojmë të gjithë këta formularë për verifikim në Prokurorinë e Përgjithshme. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Nëse nuk gabo, në këtë listë janë edhe rastet e sjella në vëmendjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga Partia Socialiste dhe koalicioni “Bashkë Fitojmë” për kandidatët respektivë, edhe nga Partia Demokratike. Apo jo?

Z. I. Sefa: Po.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Z. I. Sefa: Propozimi im, zoti Komisioner, është që t'i marrim emër me emër sipas listës, kemi kohën e mjaftueshme, na keni në dispozicion, mund t'i diskutojmë rast pas rasti. Ne kemi bërë kërkesat tona pranë Komisionerit, por unë mendoj dhe kërkoj nga Komisioneri që të marrë një vendimmarrje ku t'i shqyrtojë emër për emër apo, do të ngremë pretendime në lidhje me ato çfarë kemi ne rëspektivisht?

Z. I. Celibashi: Për ekonomi shqyrtimi, vendimmarrja do të jetë për secilin emër më vetë.

Z. I. Sefa: E mira është të bëjmë debatin për secilin emër.

Z. I. Celibashi: Pikërisht këtë isha duke thënë, për secilin nga rastet që ju keni interesin ose do të donit të trajtohet specifikisht, ne jemi dakord, por paraprakisht ju bëj me dije që karakteristika ligjore është e përbashkët e të gjithëve. Këta ose kanë deklaruar të dhëna që lidhen me akte apo veprime të ndodhura në territore të shteteve të huaja, dhe për KQZ-në kjo është e mjaftueshme që të fillojë një proces hetimi të thelluar, ose janë raste të denoncuara rëspektivisht nga subjektet politike: Partia Demokratike, koalicioni “Bashkë Fitojmë” ose Partia Socialiste. Por ju jeni të lirë që për secilin nga rastet të mbani qëndrimet tuaja, domethënë nuk kemi asnjë lloj kufizimi në lidhje me këtë.

Z. I. Sefa: Po e fillojmë nga vetja një herë. Unë nuk shoh ndonjë problematikë. Çfarë problematikash keni me listën e këshilltarëve të Partisë Demokratike, mund t'i çoni të gjithë pa përjashtim, jo vetëm këta, mund të çoni të gjithë listën për verifikime të detajuara, nuk kemi asnjë shqetësim, madje jemi të gatshëm dhe aty ku konstatojnë


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

që mund të ketë një interpretim të ligjit, jemi të gatshëm edhe të tërheqim kandidatët dhe t'i zëvendësojmë, sipas dispozitave ligjore. Nuk kemi asnjë lloj problemi. Ne jemi ata që e kanë iniciuar ligjin e dekriminalizimit, ata që e kanë mbështetur që në momentin e parë dhe ata që e kanë kërkuar ligjin e dekriminalizimit dhe jemi të parët që e respektojmë atë. Në lidhje me pretendimin, zoti Komisioner, që keni çuar përsëri për verifikim zotin Agron Kapllanaj, ju kujtoj na bën nder, që për të disatën herë, në mos gaboj të 4–ën herë, e çojmë për verifikim. Kemi vendimin e 9 janarit 2023: “Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues, zotin Agron Kapllanaj”. Keni qenë ju, zoti Komisioner, konstatimi i zotit Agron Kapllanaj, kandidat për deputet i qarkut të Fierit, nuk përfshihet në kushte ndalimi. Kemi vendim të Gjykatës Kushtetuese, kemi dhe vendimin e KQZ –së të vitit 2017. Kështu që unë nuk e kuptoj dëshirën e madhe se çfarë ka ndryshuar për 3 muaj, por gjithsesi jeni të detyruar që të zbatoni vendimin e marrë prej jush në datën 9 janar 2023. Gjithsesi, ankimi i Partisë Demokratike është për zotin Qerim Ismail Ismailaj, që kërkoni ta çoni për verifikim pranë Prokurorisë së Përgjithshme. E keni çuar një herë në 2020-n, vendosët që nuk është në kushte ndalimi. Bëri kallëzim Partia Demokratike, e dënoi si falsifikator. Edhe atëherë ishim ne prapë që bëmë kërkesën, zoti Komisioner. E vërtetuar një herë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka interpretuar ligjin në mënyrë jo të saktë dhe koha na dha të drejtë. Tani ju e çoni për një dënim që zotëria e ka marrë në Greqi, që nuk e dinte, fatkeqësisht, ndërkohë që nga vendimi i Gjykatës së Posaçme Kundër Krimit të Organizuar për Korrupsion vërtetohet që ka qenë edhe në sallën e gjyqit, e kanë vërtetuar që ka qenë në dijeni, ka bërë veprime aktive e të gjitha me radhë dhe është dënuar me 6 muaj. Me 6 muaj burgim, çfarë do të thotë? Dispozita që jua kemi vënë në dijeni, me anë të shkresës të depozituar në datën 6, është e qartë me nr. protokollit 34/22 dhe më konkretisht po marrim dispozitën në nenin 2, pika “ç”, ku thuhet:


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

“Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak. Në çdo rast nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e kryeministrit apo anëtarë të Këshillit të Ministrave, apo me votim nga këshilli bashkiak ose qarku, persona të cilat janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për pikat “ç”, për kryerjen me dashje të një krimi, që nuk përfshihet në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike dhe kur janë dënuar jo më pak se me 6 muaj burgim”. Ne me të vërtetë jemi juristë, po edhe 2 gjëra nga matematika i dimë, kur thuhet jo më pak se 6 muaj, 6 muaj përfshihet, dhe zotëria që është dënuar me 6 muaj burgim. Edhe në vendimin e gjykatës së posaçme, me nr. 11, në faqen 27 të saj thuhet: “Ana subjektive: i pandehuri ka kryer vepër penale në formën e dashjes direkte, formë e cila përbën edhe shkallën më të lartë të fajit. Në këto kushte gjykata vlerëson se shkalla e fajësisë së pandehurit është e lartë”. Vepra është me dashje, është 6 muaj dhe është në pikën “ç”. Ka edhe interpretim që mendoni pastaj që meqë e ka pezulluar gjykata këtë dënimin me 40 orë punë publike, nuk jemi në kushtet e ndalimit, por neni është treguar vizionar dhe në nenin 4, pikën 9, thuhet: “Ulja e masës së dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar apo procedurë të ngjashme me të, që passjell uljen e dënimit, amnistia, depenalizimi, falja, pezullimi i dënimit, lirimi i parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim dënimi, në përputhje me ligjin, nuk ndikojnë në zbatimin e këtij ligji dhe nuk përlllogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimit të parashkruar nga ky ligj”. Pra, ai neni 63 i famshëm, që në kokë e ka “pezullimi i dënimit me burgim për kryerjen e një pune për interes publik”, që fillon me pezullimin e ka në kokë, e ka në titull ai pezullimin, e kap kjo pika 9 këtu poshtë, se unë e di që i njihni mirë ligjet, se keni Kodin Penal, e keni formalizuar, dhe kjo është dispozita, e pengon këtë zotërinë të kandidojë. Përveç kësaj, thotë referojuni edhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

nenit 69 të Kodit Penal, që është periudha e rehabilitimit. Quhen të padënuar, thotë shkronja “a”, ata që janë dënuar me burgim për një kohë deri në 6 muaj ose me çdo dënim tjetër më të lehtë dhe që gjatë dy viteve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale. Ky zotëria në vitin 2025 mund të kandidojë, në mars të vitit 2025.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani nuk kandidon ai. Po, pasi të mbarojë dyvjeçarën e kësaj, më 29 mars, e kap periudha tjetër, sepse i bie që meqë janë në maj zgjedhjet, e kap periudha tjetër. Nuk kandidon dot ky zotëria. Ka edhe një gjë interesante, si person, që i paraprin edhe efekteve ligjore, në formularin e dekriminalizimit datë 27 mars thotë vendim i formës së prerë. Tani, ose ne nuk shohim, ose unë e shoh, por gjykata e ia ka dhënë datë 29.03 këtij. Kështu thotë gjykata, çuditërisht. Nuk di si e ka informuar ky që e ka marrë formë të prerë dy ditë përpara. Zoti Komisioner, ky nuk është për verifikim të thelluar, ky është për t’u ndaluar. Verifikimin e thelluar e bëmë njëherë në vitin 2022, na doli falsifikator, i erdhi memorja në gjykatë, u dënua. Ky nuk është për verifikim. Ky është për ndalim. Unë mund ta besoj që Komisioneri nuk e ka pasur këtë vendim në dosje, sepse patjetër që është e qartë, dua ta besoj këtë fakt. Por ky dënim është i qartë, ky është dënuar me 6 muaj burgim. Në bazë të ligjit ky nuk duhet të kandidojë. Periudha e ndalimit i mbaron më 29 mars, zotërisë. Kur t’i mbarojë le të vijë të votohet. Por ligji është për t’u respektuar dhe jo për t’u interpretuar. Siç e ka shprehur edhe ky Komisioner më parë, Komisioneri e lexon ligjin në germë dhe jo në frymë, siç e ka bërë dhe më parë, besoj do ta lexojë dhe këtë radhë, duke lexuar në germë. Dhe dispozita është qartësisht e shprehur që këtij zotërisë i ndalohet kandidimi. Dhe kjo bëhet vetëm me vendimmarrje të Komisionerit dhe nuk bëhet as *prima facia*, por duhet me dokumente të thelluara të cilat ne i kemi vendosur në dispozicion të Komisionerit. Nuk ka nevojë për hetim të

*Zbardhi materialin audio
Merița DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

thelluar ky, sepse dënimi jashtë shteti mbaroi punë e ka deklaruar ai. I ka ardhur memoria e ka deklaruar. Këtij do t'i ndalohej kandidimi për dënimin brenda Republikës së Shqipërisë. Ndaj Komisioner, është humbje kohe, siç thashë dhe më parë, afatet dyvjeçare të prokurorisë nuk janë për zbatimin e ligjit, janë për shtyrjen në kohë. Komisioneri duhet të marrë vendim për ndalimin e kandidimit të zotërisë Qerim Ismail Ismailaj, si person i dënuar për falsifikim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Në lidhje me këtë rast, dhe me rastet e tjera, mendoj se është detyrimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që qoftë edhe formalisht ta respektojë procedurën për raste kur lidhen me interpretime të akteve apo të deklarimeve të akteve, të cilat janë deklaruar në formularin e dekriminalizimit dhe këto akte lidhen me veprime apo mosveprime të ndodhura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky element ekziston edhe në rastin konkret për këtë kandidat, tej asaj që është edhe akti të cilin ju e sollët në referim. Kjo nuk e pengon Komisionerin Shtetëror që sot nesër apo pasnesër të vendosë për këtë rast, nëse do të duhet të vendosë, sikurse edhe për raste të tjera, të cilat jo domosdoshmërisht janë të lidhura me pritjen e informacionit nga ana e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, por formalisht për procedurë do të duhet ta kryejmë. Edhe një gjë tjetër që do të doja ta sqaroja, lidhet me faktin që regjistrimi i këtij kandidati është bazuar në një vendimmarrje jo të Komisionerit Shtetëror, bazohet në vendimmarrjen e Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor. Nuk e ka regjistruar Komisioneri këtë si kandidat, e ka regjistruar Komisioni Zonal i Administrimit të Zgjedhjeve. Pra, procesi i regjistrimit të tij si kandidat është bërë nga Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor. Komisioneri shqyrton vetëm përputhshmërinë e kushteve të kandidimit të tij në shqyrtim të formularit. Por ky është regjistruar, nuk ka pasur asnjë mekanizëm për ta penguar deri tani regjistrimin e tij si kandidat.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Z. I. Sefa: Edhe një herë siç jeni në dijëni dhe siç e referuat dhe vetë, zoti Komisioner, regjistrimi si kandidat është procedurë tekniko-ligjore ku plotëson kushtet formale. Autoriteti i ngarkuar me ligj për verifikimin e kushteve të zbatueshmërisë së ligjit nr.138 të vitit 2015 jeni ju, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.


Z. I. Celibashi: Unë thashë ekzaktësisht të njëjtën gjë.

Z. I. Sefa: Po, pra ne jemi dakord aty. Por nuk merret KZAZ-ja për interpretimin e ligjit të dekriminalizimit lejohet apo jo ky, merreni ju.

Z. I. Celibashi: Absolutisht këtë thashë. Ishte përgjigje e një shqetësimi institucional tuajin.

Z. I. Sefa: Unë nuk kërkoj çregjistrimin e kandidimit nga KZAZ-ja. Nuk më hyn në punë fare. Mua më intereson që ju si Komisioner të merrni vendim që ky zotëria, kandidat i propozuar nga Partia Socialiste është në kushte e ndalimit të përcaktuar në germën e ligjit, në mënyrë specifike. Kur thotë dispozita jo më pak se 6 muaj, përfshihet 6-muajshi, kur dënohesh 6 muaj je i përfshirë je i djegur. Tani, a duhet të ishte më i vëmendshëm zotëria, është halli i atij. A duhet ta ankimonte, është problemi i atij. Ky nuk është më problemi ynë. Problemi është që këtu duhet zbatuar ligji dhe autoriteti i vetëm për zbatueshmërinë e këtij ligji jeni ju, dhe ne jua kërkojmë juve. Ju kemi bërë një kërkesë për të cilën nuk e kam marrë akoma sot e kësaj dite një përgjigje. Kërkesë me të cilën ju kemi vënë në dispozicion dhe dokumentet, që mendojmë që ju nuk i kishit në momentin që keni marrë atë vendimin e verifikimit *prima facia*. Ndërkohë, mbas marrjes së kësaj kërkesë ne jemi në pritje për ju, për një vendimmarrje nga ana juaj. Do e rishikoni atë vendimmarrje, apo mendoni se është në përputhje me ligjin? Ne kërkojmë një shpjegim nga ana juaj, në lidhje me këtë kërkesë, kërkesa 34, nr. 21 të protokollit, me datë 6.04.2023.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Z. i. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësues të partive të tjera politike, të subjekteve të tjera?

Përfaqësuesi i Koalicionit Bashkë Fitojmë: Po i nderuar, në lidhje me këtë çështje jo, nuk kemi asgjë specifike, por në lidhje me listën, i nderuar zoti Komisioner, të kandidatëve që kanë ardhur, kemi dy ndërhyrje. E para në lidhje me pikën 13 të rendit të ditës, që ka të bëjë me kandidatin e Bashkisë Kuçovë, të paraqitur dhe të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, zotin Kreshnik Riza Hajdari. Atëhere siç jeni dhe në dijeni, zotëria në fjalë është subjekt i disa denoncimeve nga banorët e zonës, por edhe nga mediat investigative, gjithashtu bazuar në këto fakte dhe indicie, bazuar dhe mbi prova, Koalicioni Bashkë Fitojmë, me shresën nr. 220 protokolli, datë 4.04.2023, i ka përcjellë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në rrugë zyrtare, kërkesën për verifikimin e pastërtisë së figurës të shtetasit Kreshnik Hajdari. Konkretisht pa u zgjatur jemi bazuar tek dokumenti ‘Vendim gjykate i Janinës, shteti Grek’, vendim dënimi ndaj këtij personi për shkelje të rregullave të kufirit, po themi në shtetin grek. Atëherë, është dhe rezulton e qartë se ky dënim nuk është pasqyruar nga vetë kandidati në formularin e dekriminalizimit, në kundërshtim me ligjin nr. 138/2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike. Pra me vetedije, ky kandidat edhe në zgjedhjet e mëparëshme, por edhe kësaj rradhe, nuk e ka paraqitur, rezulton se nuk e ka paraqitur këtë të dhënë, këtë informacion. Duke qënë se pak ditë pas depozitimit dhe pas mylljes së kandidaturave dhe pas depozitimit të formularit të kandidimit, jemi vënë në dijeni, ne si koalicion të këtij elementi, pra të vendimit të gjykatës së Janinës, ku ky kandidatë, ky shtetas, zoti Kreshnik Hajdari, i datëlindjes 29 korrik 1982, lindur në Berat, me vendimin numër 32/86, datë 2 qershor 1999, rezulton se është dënuar nga gjykata e shkallës së parë Janinë me katër muaj burg, për hyrje të paligjshme në

*Zbardi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

territorin e Republikës Greke. Me shkresën përcjellëse, i nderuar Komisioner, ju kemi vënë në dispozicion vendimin orgjinal, të përkthyer, me përkthim zyrtar dhe me vulë apustile. Shkurtimisht, në kuadër të zbatimit të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, informacioni i bërë publikë dhe i vënë në dispozicion nga ana jonë, i cili i është bashkangjitur kërkesës, krijon bindjen se funksionari ka shkelur dispozitat ligjore, që kanë të bëjnë me zbatimin e drejtë, transparent dhe frymën me të cilën funksionon ligji i dekriminalizimit, duke bërë të mundur në këtë mënyrë që të pengohet kandidimi i tij. Përsa më sipër, ne kërkojmë nga ana juaj i nderuar Komisioner, si autoritet i ngarkuar nga ligji, që pasi të bëni verifikimet e nevojshme lidhur me pastërtinë e figurës së shtetasit Kreshnik Hajdari, të deklaroni se ky i fundit është në kushtet për ndalimin e zgjedhjes, mosemërimit apo largimit nga funksioni publik. Kjo ishte ndërhyrja e parë, ndërhyrja e dytë që kisha si përfaqësues i Koalicionit Bashkë Fitojmë, ka të bëjë me pikën 18, në mos gaboj, të rendit të ditës, që flet për kandidatin e koalicionit tonë në Bashkinë Shijak, zotit Rezeart Xhelal Tusha. Këtu deshëm thjesht të theksojmë dhe një herë dhe të sjellim në vëmëndjen tuaj i nderuar Komisioner, se kandidati jonë nuk e ka për herë të parë kandidimin, ai ka kandiduar dhe në zgjedhjet e mëparshme dhe theksojmë se e ka kaluar njëherë filtrin e ligjit të dekriminalizimit, pra e shohim të tepërt në këtë rast që të bëhet përsëri një filtrim i dytë kur ai tashmë e ka kaluar një herë këtë filtër, ka kandiduar në zgjedhjet e mëparshme, zyrtarisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Së dyti, kandidati ka arritur të marrë nga shteti i Zvicrës një dokument zyrtar në lidhje me dëshminë e penaltetit, po themi, të shtetit të Zvicrës, ku figuron se nuk ka asnjë lloj vendimi dhe është i gatshëm nëse i kërkohet, ta vëjë në dispozicion pa asnjë lloj problem. Pra ne gjuajmë se, në lidhje me kandidatin e Koalicionit Bashkë Fitojmë, për Bashkinë Shijak, zotit Rezeart Xhelal Tusha, nuk ka asnjë arsye pse të vazhdohet me hetime të thelluara. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Po, zoti Sefa.

Z. I. Sefa: Në lidhje me rastin e Kuçovës, zoti Komisioner, duke qënë se mund të kemi dhe raste të ngjashme siç kemi patur dhe në të kaluarën që jemi detyruar të bëjmë zgjedhje përsëri, kërkoj një veprim aktiv nga ana juaj, mbase me përfaqësues të subjekteve, sepse mesa dëgjova dhe vetë kandidatin, ka deklaruar që nuk ka qënë në dijeni por rezulton që ka qënë në dijeni, në mos gaboj. Në qoftë se ka qënë në dijeni të vendimmarrjes zoti Kryetar, ne jemi në dijeni, të gjithë palët këtu, se si është përfundimi i gjithë kësaj procedure. Do na detyroni të bëjmë zgjedhje në Kuçovë pas një viti prapë. Kërkoj nga ju të merren vendime imediate, sa më të shpejta, për t'i kursyer shqipëtarëve zgjedhje pas një viti prapë.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Atëhere, për rastin e kandidatit për kryetar të Bashkisë së Kuçovës të mbështetur nga Partia Socialiste, zotin Kreshnik Riza Hajdari, mendoj që jemi në kushtet kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të duhet të kërkojë prej organit të Prokurorisë së Përgjithshme informacion në lidhje me aktin nga pikëpamja juridike, të deklaruar ose të pretenduar të kryer nga ky kandidat, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, edhe sikurse besoj ju shumë mirë e dini, sipas përcaktimeve të ligjit për dekriminalizimin, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka kompetencën që ta bëjë këtë vlerësim, por duhet që këtë vlerësim ta bëjë organi i Prokurorisë, që do të thotë, me një gjuhë ndoshta pak më të qartë, është ai autoriteti, sipas ligjit, në Republikën e Shqipërisë, i cili bën vlerësimin nga pikëpamja penale të aktit të verifikua, të ndodhur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe mbi atë vlerësim ne do të vendosim nëse kandidati në fjalë është në kushtet për të kandiduar apo jo, kështu që në respekt të ligjit do të duhet ta bëjmë

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

këtë procedurë pasi edhe pse ne me njëri tjetrin shumë mirë mund ta kuptojmë sesi është kjo situata nga pikëpamja ligjore, por vlerësimin për këtë fakt, sesi qëndron në raport me ligjin penal Shqipëtar, do të duhet ta bëjë organi i Prokurorisë. Jam i sigurtë që qoftë ju, apo kushdo tjetër nuk do të pëlqente, të interes politik, që të ndodheshim në situatën që kandidati në fjalë mos ishte në kushtet për të kandiduar dhe rrjedhimisht, nesër, pasnesër, nëse ky do ta marri mandatin, se këtë nuk e dimë, ju e morrët të mirqënë se do përsërisim zgjedhje, por ne nuk e marrim të mirqënë se nuk e dimë do fitojë apo nuk do fitojë ky kandidat, por kjo të mos ndodhi për këtë shkak. Kurse përsa i përket rastit të kandidatit zotit Rezart Xhelel Tusha, për të cilin ka pretendime nga Partia Socialiste, edhe pse jam dakord me konstatimin e përfaqësuesit të Koalicionit Bashkë Fitojmë, në kuptim të faktit që është bërë verifikimi për këtë kandidat, gjithsesi jemi të detruar formalisht nga ligji që qoftë edhe për këtë periudhën, nga momenti kur është bërë verifikimi i parë deri më tani, të kërkojmë informacion nga organi Prokurorisë së Përgjithshme, për të cilin logjikisht mendohet se nuk do të ndryshojë situatën, por gjithsesi ne do të duhet ta çojmë për verifikim të thelluar sa kohë që janë të dhënat, indiciet për ta bërë diçka të tillë. Kemi gjë tjetër? Nuk kemi! Po, përfaqësuesi i Partisë Lëvizja e Legalitetit!

Përfaqësuesi i Partisë Lëvizja e Legalitetit: Pashkë Gjetaj në Pukë, është kandidatë për Partinë Lëvizja e Legalitetit, momentalisht ai është anëtar i këshillit bashkiak atje, kështu që për t'ju ndihmuar ndoshta, meqë e ka kaluar një herë ciklin.

Z. I. Celibashi: Po, vlen i njëjti arsyetim, sepse përndryshe të gjithë që e kalojnë një herë, le të themi filtrin, do të duhet të supozohet që nuk kanë më verifikim për herë të dytë ose të tretë, por ligji nuk e parashikon këtë. Sa herë që është rasti që një subjekt i cili i është nënshtruar procesit të verifikimit, e ka kaluar këtë proces

*Zbardi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

verifikimi në një kandidatim të dytë të tij, do të duhet përsëri t'i nënshtrohet procesit të verifikimit. Kjo është zgjedhje e ligjvënësit, dhe se sa me dobi është kjo çështje pastaj është një diskutim tjetër, që nuk jemi në kohën dhe në vendin për ta bërë këtë. Kemi gjë tjetër? Po, zoti Sefa!

Z. I. Sefa: Për kandidatët që nuk janë në këtë rend dite, ju e përcaktuat qartë vetëm ata që janë dënuar, kanë precedent penal për jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, por ka edhe kandidatë të cilët e plotësojnë këtë formularin e vetëdekriminalizimit në mënyrë të çuditshme, me thënë të drejtën, ca e shkruajnë vetëm gjobë, ndërkohë që formulari thotë sa je dënuar me burgim. Thotë gjobë, nuk thotë masën e gjobës, pushim çështjeje thotë në një vend, rezulton që ky kandidati i Divjakës, i Partisë Socialiste, është dënuar për kontrabandë me mallra të tjerë, nga neni që ka përcaktuar këtu, po nuk është fare i qartë, domethënë thotë në 2008 është dënuar për kontrabandë. Do e çoni për verifikim këtë apo s'ka nevojë ky? Prokuroria e Përgjithshme, që të marrim ca të dhëna nga këto se ngaqë ne i lexojmë thjeshtë si formularë kështu, por nuk e dimë sa është dënuar, si është dënuar, kur është dënuar.

Z. I. Celibashi: Për dijeninë tuaj, ne jemi në proces verifikimi, kjo është një listë e parë të themi, jemi duke vazhduar procesin e verifikimit dhe për raste të tjera, dhe në dijeninë time kemi dhe raste të tjera.

Z. I. Sefa: Ngaqë janë këto formulimet njëçikë të çuditshme dmth., te kjo ku thotë dënim gjyqësor me formë të prerë, deklaron pushim çështjeje por se çfarë çështjeje, se ajo ka pikë tjetër të deklaramit por e ka deklaruar këtu si duket, te njëri thotë që është dënuar për kontrabandë me mallra të tjerë, prandaj kjo është interesante, mendoj që duhet ta... dhe komisioni këtë.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Z. I. Celibashi: Për çfarë ne konstatojmë, do t'i kemi objekt shqyrtimi në seancë publike, por natyrisht ju keni gjithë të drejtën të sillni në vëmendje të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rastet të cilat ju i çmoni që kanë nevojë për shqyrtim dhe eventualisht edhe për verifikim të detyruar të të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit.

Z. I. Sefa: Patjetër zoti Komisioner, ne jemi dakord me këtë, shpresojmë që të mos kthehet edhe ky rezultat verifikimi si komisioni Bezhani që dolën të gjithë të pastër, të kapi dhe rrjeta ndonjëherë, mos presim vetëm ndihmën e Partisë Demokratike për t'i mbledhur.

Z. I. Celibashi: Çfarë është në kompetencën tonë për ta përdorur rrjetën, nuk na mungon as vullneti dhe nuk kemi asnjë lloj ndrojtje dhe një gjë do të duhet ta themi që, të paktën në vlerësimin tim, që ka qenë gjithë kujdesi i subjekteve, partive politike, që të prezantojnë kandidatë, të paktën sipas dijenisë së tyre, jo me probleme me ligjin penal por ndërkohë rezulton që lista nuk është e vogël, mund të jetë pak relativisht numrit të madh prej 23800 kandidatësh, por gjithsesi edhe ky numër deri më tani 34 rastesh, nuk është i pakët, edhe mund të ketë raste të tjera.

Z. I. Sefa: Ne e dimë fluksin e jashtëzakonshëm të punës, ju falenderojmë dhe për këtë nuk diskutohet, ne kërkojmë ndjesë edhe në qoftë se ndonjë nga ana jonë ka kaluar, jemi të gatshëm të marrim edhe masat tona përpara se të vendosi Komisioneri, për çfarëdolloj rasti që mund të ketë dhe interpretim ligjor, jo vetëm në kushtet e ndalimit, kushtet e ndalimit nuk egzistojnë fare, jemi të gatshëm që moment t'i tërheqim, por edhe mund të jetë interpretim ligjor, përsëri kemi të njëjtin

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

vullnet për të marrë masa ne si subjekt zgjedhor, kjo nuk është, ky vullnet është i padiskutueshëm.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, mendoj që kjo ju bën nder juve dhe partive të tjera në raste të ngjashme. Mirë, atëherë do të vendosim që të dërgojmë për verifikim të thelluar, për formalitet po i lexoj, kandidatin për Kryetar të Bashkisë Kuçovë propozuar nga Partia Socialiste zoti Kreshnik Riza Hajdari, kandidatin për Kryetar të Bashkisë Krujë mbështetur nga Partia Socialiste Artur Xheke Bushi, kandidatin për Kryetar të Bashkisë Vai i Dejës zoti Kristian Luigj Shkreli mbështetur nga Partia Socialiste, kandidatin për Kryetar të Bashkisë Has zotin Beqir Zek Mulaj propozuar nga Partia Socialiste, kandidatin për Kryetar të Bashkisë Shijak zotin Rezart Xhelal Tusha propozuar nga Koalicioni Bashkë Fitojmë, kandidatin për Kryetar të Bashkisë Devoll zotin Elvis Jani Hajdëlli propozuar nga Koalicioni Bashkë Fitojmë, kandidatin për Kryetar të Bashkisë Himarë zotin Dionisios Alfred Petro Bejleri propozuar nga Koalicioni Bashkë Fitojmë, kandidatin për Kryetar të Bashkisë Mallakastër zotin Agron Faslli Kapllani propozuar nga Partia Demokratike, kandidatin për Kryetar të Bashkisë Kukës zotin Abedin Rasim Ruçi propozuar nga Partia Bashkimi i Europeanizimit dhe Integritit të Shqipërisë, kandidatin për Kryetar të Bashkisë Bulqizë zotin Arjan Liman Xhela propozuar nga Partia Demokratike, kandidatin për anëtar të këshillit bashkiak zotin Artur Due Ndreu propozuar nga Partia Demokratike për këshillin e bashkisë Mirditë, kandidatin për anëtar të këshillit të Bashkisë Shijak zotin Taulant Hakip Daja propozuar nga Partia Demokratike, kandidatin për anëtar të këshillit të Bashkisë Tropojë zotin Fadil Bujar Sokolaj propozuar nga Partia Demokratike, kandidatin për anëtar të këshillit bashkiak, Bashkia Bulqizë zotin Ylli Rushit Xhafa propozuar nga Partia Demokratike, kandidatin për anëtar të këshillit të Bashkisë Berat zotin Sulja Zedin

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2023*

Çoku propozuar nga Partia Demokratike, kandidatin për anëtar të këshillit bashkiak të Bashkisë Tropojë zoti Adriatik Kadri Sallau propozuar nga Partia Aleanca Rinore Kombëtare, kandidatin për anëtar të këshillit bashkiak të Bashkisë Pukë zotin Pashkë Gjergj Gjetaj propozuar nga Partia Lëvizja e Legalitetit, kandidatin për anëtar të këshillit bashkiak të Bashkisë Gramsh zotin Sokol Abedin Kullolli propozuar nga Partia Reforma Demokratike Shqipëtare, kandidatin për anëtar të këshillit të Bashkisë Tiranë Zotin Afrim Ali Kica propozuar nga Partia Lëvizja e Legalitetit, kandidatin për anëtar të këshillit bashkiak të Bashkisë Tiranë zotin Kreshnik Faslli Myrtollari propozuar nga Partia Agrare Ambjentaliste, kandidatin për anëtar të këshillit Bashkisë Shkodër Arbis Arif Vjerdha propozuar nga Partia Agrare Ambjentaliste, kandidatin për anëtar të këshillit Bashkisë Shijak zoti Armelin Qazim Koni Partia Aleanca Progresiste LZHK, kandidatin për anëtar të këshillit Bashkisë Vlorë zotin Arsen Tare Belaj propozuar nga Partia Aleanca Progresiste LZHK, kandidatin për anëtar të këshillit bashkiak zoti Ali Hekuran Gjeta për Bashkinë e Bulqizës propozuar nga Partia Aleanca Progresiste LZHK, kandidatin për anëtar të këshillit të Bashkisë Kuçovë zotin Marceljo Sami Marra propozuar nga Partia Aleanca Progresiste LZHK, dhe do ta shtyjë vendimmarrjen për kandidatin për Kryetar të Bashkisë Mallakastër zotin Qerim Ismailaj, pasi të vlerësojmë dokumentacionin të cilin solli në vëmendje të Komisionerit përfaqësuesi i Partisë Demokratike. Çështje të tjera, nuk kemi? Mirë, Faleminderit! Seanca mbyllet.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

